REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT

# Buletini i Turizmit

*Raportim Mujor*

***Dhjetor 2018***

# PËRMBAJTJA

**HYRJE**

1. **VIZITORË TË HUAJ TË HYRË PËR MUAJIN DHJETOR 2018……. fq.3**

    **1.1. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve**

    **1.2. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

    **1.3. Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit**

2. **TURIZMI KULTUROR……………………………………………………fq.6**

3. **TURIZMI NATYROR…………………………………………………… fq.8**

# 1 HYRJET E VIZITORËVE TË HUAJ PËR MUAJIN DHJETOR 2018

Sipas të dhënave të publikuar nga INSTAT, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Republikën e Shqipërisë, për muajin dhjetor 2018 është 280,699, ose 9 % më shumë se muaji dhjetor i vitit 2017.
Pas publikimit të të dhënave për muajin e fundit të vitit llogaritet tashmë se vizitorët e huaj të hyrë gjatë vitit 2018 janë 5,926,803. Viti 2018 shënoi rritjen më të madhe në këto 5 vitet e fundit për hyrjen e vizitorëve të huaj, rreth 15,8%, më shumë se viti paraardhës. Më poshtë gjeni tabelën kahasuese:

| Periudha | Dhjetor 2017 | Dhjetor 2018 | Rritja (%) | Janar-Dhjetor 2017 | Janar -Dhjetor 2018 | **Rritja(%)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vizitorët e huaj | 257, 474 | 280,699 | 9 | 5,117,700 | 5,926,803 | 15,8 |

Nga paraqitja grafike mujore të periudhës janar-dhjetor 2018 të shtetasve të huaj, që kanë hyrë në Shqipëri, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2017, vëmë re se ende muajt e verës sjellin numrin më të madh të vizitorëve të huaj, ku vlera më e lartë është arritur në muajin Gusht, Korrik e Shtator.



## 1.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Referuar qëllimit që deklarojnë shtetasit e huaj që vizitojnë Shqipërinë rezulton se në muajin dhjetor 260,009 shtetas të huaj I qëndrojnë përkufizimit "turistë", pra që shpenzojnë më shumë se një narë në vendin tonë. Në këtë muaj janë 8,6 % më shumë krahasuar me "turistët" e të njëjtit muaj të 2017. Më poshtë është tabela e vizitorëve të huaj sipas qëllim të vizitës së tyre, që deklarojnë në pikat tona kufitare:

| Periudha | Dhjetor 2017 | Dhjetor 2018 | Janar-Dhjetor 2017 | Janar-Dhjetor 2018 | Rritja progresive % |
|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej | 257,474 | 280,699 | 5,117,700 | 5,926,803 | 15,8 |
| I. Personale | 252.240 | 274.079 | 5,049,173 | 5,839,626 | 15,7 |
| Pushime, miq e të afërm. Te tjere | 233,990 | 257,301 | 4.865.841 | 5.639.818 | 15,9 |
| Trajtim shëndetësor | 19 | 34 | 634 | 276 | -56,5 |
| Qëllime fetare | 29 | 54 | 601 | 778 | 29,5 |
| Tranzit | 18.202 | 20.690 | 182.097 | 198.754 | 9,1 |
| II. Biznes dhe profesionale | 5.234 | 6.620 | 68.527 | 87.177 | 27,2 |

***Burimi INSTAT***

## 1.3 Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit

Gjatë muajit dhjetor 2018 kanë hyrë gjithsej 833,200 udhëtarë vendas dhe të huaj duke shënuar një rritje prej 12,3 %, krahasuar me të njëjtën muaj të një viti më parë. Edhe në këtë muaj, udhëtimi me mjete tokësore mbetet udhëtimi më i preferuar për vizitorët e huaj dhe shqiptarë.

Në tabelën më poshtë jepet lloji i udhëtimit të shtetasve të huaj dhe shqiptarë, që kanë zgjedhur gjatë muajit dhjetor 2018, krahasuar kjo me të njëjtin muaj të vitit 2017:

| **Nr.** | **Mënyra e udhëtimit** | **Periudha** | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Dhjetor 2017 | Dhjetor 2018 | Ndryshimi vjetor ne % |
| **1** | Me ajër | 114.992 | 121.666 | 5,8 |
| **2** | Me det | 50.885 | 55.457 | 9,0 |
| **3** | Me tokë | 575.808 | 656.077 | 13,9 |

***Burimi INSTAT***

Në lidhje me raportin e mënyrës së transportit të zgjedhur nga vizitorët e huaj për të hyrë në Shqipëri në muajin dhjetor 2018 me numrin e hyrjeve në total të vizitorëve të huaj dhe vendas, i shprehur në %, është si më poshtë:

i. 78,8 % e të huajve dhe vendasve zgjedhin rrugën tokësore për të hyrë në Shqipëri;
ii. 14,6% e të huajve dhe vëndasve hyjnë në kufirin shqiptar në rrugë ajrore;
iii. 6,6% e hyrjeve bëhet nëpërmjet transportit detar.

## 1.4 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve

Në dhjetor 2018, ndër vendet që ka një rritje progresive më të lartë nga i njëjti muaj i 2017, janë shtetasit e huaj me nënshtetësi greke, të cilët edhe këtë muaj kanë pasur një rritje mbi 86,2% më shumë. Një rritje progresive të konsiderueshme kanë pasur dhe vizitorët nga Kosova, Zvicra dhe Anglia.

Më poshtë gjeni tabelën e hyrjes së vizitorëve të huaj për nga shtetësia:

| Shtetet | Dhjetor 2017 | Dhjetor 2018 | Ndryshimi vjetor (%) | Janar-Dhjetor 2017 | Janar–Dhjetor 2018 | Ndryshimi progresiv (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kosovë | 53.837 | 74.616 | 38,6 | 1.745.973 | 2.088.503 | 19,6 |
| Maqedoni | 67.350 | 40.676 | -39,6 | 671.570 | 680.780 | 1,4 |
| Greqi | 29.105 | 54.203 | 86,2 | 489.172 | 552.638 | 13,0 |
| Itali | 28.129 | 28.384 | 0,9 | 363.344 | 436.103 | 20,0 |
| Angli | 6.514 | 7.772 | 19,3 | 127.333 | 126.296 | -0,8 |
| Mali i Zi | 27.022 | 26.773 | -0,9 | 380.988 | 357.071 | -6,3 |
| Poloni | 671 | 455 | -32,2 | 114.582 | 153.718 | 34,2 |
| SHBA | 3.917 | 4.078 | 4,1 | 97.786 | 116.978 | 19,6 |
| Spanjë | 645 | 631 | -2,2 | 22.099 | 24.675 | 11,7 |
| Gjermani | 5.019 | 4.895 | -2,5 | 121.604 | 142.291 | 17,0 |
| Zvicër | 2.433 | 2.958 | 21,6 | 54.051 | 54.869 | 1,5 |

***Burimi INSTAT***

## 2. TURIZMI KULTUROR

Edhe pse Dhjetori është një muaj i ngarkuar me përgatitjet festive të Krishtlindjeve dhe fundit të vitit, vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të vizitorëve në institucionet kulturore. Kështu gjatë muajit dhjetor 2018, vihet re një rritje në masën 27,5**%** më shumë vizitorë në Muzetë, Parqet Arkeologjike dhe Kalatë e vendit tonë, krahasuar me Dhjetorin e 2017. Rritje kanë shënuar numri I vizitorëve në Muzeun Kombëtar të Tiranës, Muzeun e Gjergj Kastriotit Krujë, Muzeu Etnografik i Berat dhe Muzeu Ikonografik i Onufrit, Berat.

Numri i vizitorëve në kalatë dhe monumentet e tjera të kulturës është rritur me një vlerë prej 41,3 %. Gjithashtu rritje ka pësuar dhe numri i vizitorëve, që zgjedhin si destinacion kulturor parqet kombëtare dhe arkeologjike, në masën 31,8 % më shumë se dhjetori i një viti më parë. Më poshtë po japim tabelën e vizitueshmërisë së institucioneve të kulturës në muajin dhjetor e krahasuar kjo me të njëjtën muaj të vitit 2017.

| Nr. | EMËTIMI I INSTITUCIONIT | Vizitorët | |
|---|---|---|---|
| | | Dhjetor 2017 | Dhjetor 2018 |
| 1 | MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË | 841 | 1,191 |
| 2 | MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS | 346 | 324 |
| 3 | MUZEU I PAVARSISË VLORË | 113 | 117 |
| 4 | MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUJË | 1,158 | 1,572 |
| 5 | MUZEU ETNOGRAFIK, KRUJË | 233 | 202 |
| 6 | MUZEU ETNOGRAFIK BERAT | 65 | 252 |
| 7 | MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT | 386 | 852 |
| 8 | MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË, | 592 | 370 |
| 9 | MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË, | 60 | 117 |
| 10 | MUZEU ARSIMIT, KORÇË, | 705 | 517 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **11** | MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI | 329 | 632 |
| **12** | MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTËPIA ME GJETHE" | 972 | 717 |
| **TOTALI MUZE** | | **5.800** | **6,863** |
| **1** | KALAJA BERAT | 1,684 | 3,088 |
| **2** | KALAJA GJIROKASTËR | 1,215 | 1,016 |
| **3** | KALAJA PORTOPALERMOS | 7 | 10 |
| **4** | KALAJA E KANINËS | 10 | 20 |
| **5** | KALAJA E HIMARËS | 0 | 5 |
| **6** | AMFITEATRI | 102 | 126 |
| **7** | MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE | 0 | 0 |
| **8** | MANASTIRI I MESOPOTAMIT | 0 | 0 |
| **TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE** | | **3,018** | **4265** |
| **1** | PARKU KOMBËTAR BUTRINT | 310 | 720 |
| **2** | PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI | 316 | 709 |
| **3** | PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS | 187 | 95 |
| **4** | PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR | 1,840 | 2,001 |
| **5** | PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË | 55 | 50 |
| **6** | PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA | 5 | 70 |
| **7** | PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM | 10 | 27 |
| **8** | PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ | 7 | 40 |
| **9** | PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE | 85 | 0 |
| **TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK** | | **2,815** | **3,712** |
| TOTALI NUMRI I VIZIOREVE | | **11,633** | **14,840** |

***Burimi Ministria e Kulturës***

Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në Institucionet Kulturore për këtë muaj rezulton që të jenë përfituar 1,933,560 Lek.

# 4. TURIZMI NATYROR

Gjatë muajit dhjetor të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se, 91,412 vizitorë vendas dhe të huaj kanë vizituar zonat tona të mbrojtura. Siç shihet dhe nga grafiku, numrin më të madh të vizitorëve e kanë pasur Zonat e Mbrojtura në Qarkun e Korçës të ndjekura nga ato të Tiranës dhe Durrësit.

Sipas Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të ardhurat, për zonat ku vizitorët paguajnë, llogaritet që është përfituar një vlerë prej 75.000 Lek.

Më poshtë po japim një grafik të numrit të vizitueshmërisë të këtyre zonave me vlera natyrore.




***Tab 6. Burimi Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura***